REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**

**KËSHILLI BASHKIAK**

# VENDIM

**Nr. 32 , DATË 26 / 03 /2021**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" (Titulli 3, Bashkëpronësia, Neni 199 dhe vijues), të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 202, datë 05.03.2020 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të banesave individuale", Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar, të raporteve të Komisionit të Posaçëm, i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

**KËSHILLI BASHKIAK**
**VENDOSI**

1. Miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, Lagjia.17, Rruga "Lura", pallatet nr.1&3, dhe Rruga "Ahmet Dakli", pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

2. Miratimin e raportit të Komisionit të Posaçëm me nr. 2145/16 prot. datë 24.03.2021 për subjektet përfituese nga programi i rindërtimit, ish banorë të 4 banesave kolektive, Lagjia.17, Rruga "Lura", pallatet nr.1&3, dhe Rruga "Ahmet Dakli", pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm, bashkëlidhur.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së BPSHV dhe Emergjencave Civile.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**

**SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**Dorina Milja**

Me porosi dhe në mungesë;
Almeida Rrash.

**U shpall sot më datë 01.04.2021**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA DURRËS**
**KOMISIONI I POSAÇËM**

Nr. 2145/16 Prot. Durrës, më 24.03.2021

SEKRETARIA BASHKIA DURRËS

**MIRATOI**

**ZËVENDËSKRYETAR**

**Emiriana Sako**

# RAPORT

## PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17,RRUGA "LAURA", PALLATETNR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23,TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.

**E nderuar zonja Kryetare,**

Sikurse jeni në dijeni, tërmeti i fuqishëm i rënë në datën 26.11.2019, që tronditi Shqipërinë, përfshiu edhe territorin administrativ të Bashkisë Durrës, ku janë evidentuar dëme të shumta ndërtimore në të gjitha Njësitë Administrative në juridiksionin administrativ të saj. Nisur nga kjo ngjarje natyrore, e cila krijoi një situatë të papritur me pasoja të rënda për banorët e Bashkisë Durrës, duke cënuar sigurinë e tyre dhe shkaktuar dëme të mëdha për jetën e njerëzve, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar, në të cilin ishte sanksionuar fakti se për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, institucionet publike ishin të detyruara të merrnin masa të jashtëzakonshme për përballimin e kësaj situate. Konkretisht, referuar pikës 7.1, shkronjat "a" dhe "'d" institucionet publike duhej të realizonin plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe ndihmojnë në përballimin dhe lehtësimin e saj.

Në vijim, Këshilli i Ministrave, me qëllim intensifikimin e masave dhe veprimeve për përballimin e pasojave të kësaj fatkeqësie natyrore, si edhe të fatkeqësive të tjera që për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile, miratoi Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, i cili, ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Në zbatim të këtyre parashikimeve dhe në funksion të fillimit të zbatimit të programeve të procesit të rindërtimit, Këshilli i Ministrave miratoi një sërë aktesh në zbatim të Aktit Normativ, në të cilat u detajuan procedurat që duhet të ndiqen për secilin prej programeve, nga të cilat, më të rëndësishmet mund të përmendim vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar.

Vendimet e sipërcituara, krahas përcaktimit të procedurave dhe rregullave për të përfituar nga disa prej programeve të lartpërmendura, parashikojnë detyrimin e kryetarit të bashkisë për ngritjen e Zyre të Posacme të Rindërtimit për shqyrtimin e dosjeve dhe kualifikimin e tyre si dhe ngritjen e një Komisioni të Posaçëm që do të vlerësojë dhe shqyrtojë aplikimet për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit. Më specifikisht, detyrat konkrete të komisionit janë të përcaktuara në pikat e poshtëshënuara:

-Pika 8, e VKM-së nr. 904/2019: Kërkesat e plotësuara me të dhënat dhe dokumentacionin sipas parashikimit të këtij vendimi regjistrohen sipas rendit kronologjik në sistemin e posaçëm elektronik nga strukturat përgjegjëse. Regjistri i kërkesave për mbanin formacionin që mundëson përpunimin e të dhënave, si mëposhtë vijon: a) emrin, atësinë, mbiemrin; b) numrin e kërkesës; c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit; ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit; d) adresën e kërkuesit; dh) përbërjen familjare në momentin e aplikimit; e) Aktin e konstatimit/akt ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizikosejuridik, subjektisëdrejtëstregtare, ipajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme; ë) dokumentin e pronësisë ose çdo akt përfitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

- Pika 16, e VKM-së nr. 904/2019: "Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit.

- Pika 21, e VKM-së nr. 5/2020: "Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi.".

Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile, i ngritur me urdhër nr. 108, datë 12.03.2020 të Zëvendëskryetarit të Bashkisë, ka kryer shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të pronarëve të apartamenteve të 4 pallateve të L.17 Nr.1&3 rruga "Lura" dhe nr.15&23 rruga "Ahmet Dakli"

Ky dokumentacion dhe kjo listë e subjekteve përfituese i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm nga Zyra e Posacme e Rindërtimi, nëpërmjet

1. Raportit nr. 2145/12 prot. datë 24.03.2021 për Pallatin Nr.1 Rruga "Lura" ku kanë kualifikuar 29 subjekte përfituese të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit. nga të cilat 25 subjekte kanë aplikuar në platformën "Shtëpia Ime" ku është marrë gjendja familjare e datë së aplikimit.
   Si edhe 4 subjekte që nuk ka bërë aplikim tek platforma "Shtëpia Ime", pronarë të apartamenteve të pallatit Nr.1 Rruga "Lura", Zyra e Posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar dhe i ka kualifikuar në bazë të raportit të dorëzuar Komisionit të Posaçëm, duke marrë parasysh përbërjen familjare të datës së fatkeqësisë 26 nëntor 2019.
2. Raportit nr. 2145/13 prot. datë 24.03.2021 për Pallatin Nr.3 Rruga "Lura"ku kanë kualifikuar 22 subjekte përfituese të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit. nga të cilat 9 subjekte kanë aplikuar në platformën "Shtëpia Ime" ku është marrë gjendja familjare e datë së aplikimit
   Si edhe 13 subjekte që nuk ka bërë aplikim tek platforma "Shtëpia Ime", pronarë të apartamenteve të pallatit Nr.3 Rruga "Lura", Zyra e Posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar dhe i ka kualifikuar në bazë të raportit të dorëzuar Komisionit të Posaçëm, duke marrë parasysh përbërjen familjare të datës së fatkeqësisë 26 nëntor 2019.
3. Raportit nr. 2145/14 prot. datë 24.03.2021 për Pallatin Nr.23 Rruga "Ahmet Dakli" ku kanë kualifikuar 25 subjekte përfituese të dërguar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit. nga të cilat 23 subjekte kanë aplikuar në platformën "Shtëpia Ime" ku është marrë gjendja familjare e datë së aplikimit.
   Si edhe 2 subjekte që nuk ka bërë aplikim tek platforma "Shtëpia Ime", pronarë të apartamenteve të pallatit Nr.1 Rruga "Lura", Zyra e Posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar dhe i ka kualifikuar në bazë të raportit të dorëzuar Komisionit të Posaçëm, duke marrë parasysh përbërjen familjare të datës së fatkeqësisë 26 nëntor 2019.
4. Raportit nr. 2145/15 prot. datë 24.03.2021 për Pallatin Nr.15 Rruga "Ahmet Dakli" ku 22 subjekte që nuk ka bërë aplikim tek platforma "Shtëpia Ime", pronarë të apartamenteve të pallatit Nr.15 Rruga "Ahmet Dakli" Zyra e Posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar dhe i ka kualifikuar në bazë të raportit të dorëzuar Komisionit të Posaçëm, duke marrë parasysh përbërjen familjare të datës së fatkeqësisë 26 nëntor 2019.

Kjo listë e subjekteve përfiton nga programi i procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare,masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit", i ndryshuar.

Për sa më sipër, lista e subjekteve përfituese, pjesë përbërëse e këtij relacioni, është si:

- Aneksi 1 4 Pallatet e L.17

KOMISIONI I POSAÇËM:

| | |
|---|---|
| Gentian Kallmi | Kryetar |
| Ermal Lufo | Anëtar |
| Andri Cerri | Anëtar |
| Diana Mandia | Anëtare |
| Klara Agasi | Anëtare |
| Edvin Hysi | Anëtar |
| Afroviti Manthjo | Anëtare |
| Veli Ajdini | Anëtar |

Lagjja Nr.1, Sheshi "Liria", tel & fax +355 52 222 310 e-mail:info@durres.gov.al

**ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE TE 4 PALLATEVE TE L.17**

| Nr. | PRONARI | GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES | STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET |
|---|---|---|---|
| 1 | DEFRIM GODO HASKA, ARTAN GODO HASKA | 4+4 | 3+1 |
| 2 | ADNAN ESAT DAJLANAJ | 2 | 1+1 |
| 3 | FADIL KAMBER KAMBERI, VJOLLCA FAHRI KAMBERI | 4 | 2+1 |
| 4 | BEDRI MENTOR QUKU | 4 | 2+1 |
| 5 | XHELADIN RAMADAN USHIMA, FATMIRE BAJRAM USHIMA, EDMOND XHELADIN USHIMA | 6(2+4) | 3+1 |
| 6 | LIMAN MUSTAFA KUKLI | 2 | 1+1 |
| 7 | NEZIR VESEL HOXHA, ENGJELLUESHE SHUAIP HOXHA | 2 | 1+1 |
| 8 | BESIM ABDI BAKALLI , VIOLETA RAMIZ BAKALLI, | 2 | 1+1 |
| 9 | DENADA RIBAJ, MIRANDA ZIBERI | 4+1 | 3+1 |
| 10 | ELISON SHABAN KUTELI | 3 | 2+1 |
| 11 | SUKSES LIMAN KUKLI, GENTIAN LIMAN KUKLI | 9 | 3+1 |
| 12 | EDLIRA LUSHI | 8 | 3+1 |
| 13 | LEFTERI DURMISHI ADELA DURMISHI | 2 | 1+1 |
| 14 | KATERINA MINO ORMANIDHI, MESILA HEKTOR ORMANIDHI, ARJETA HEKTOR GRINGMUTH | 3(2+1) | 2+1 |
| 15 | FERDI VELÇANI | 4 | 2+1 |
| 16 | GEZIM ÇERA | 2 | 1+1 |
| 17 | KOZMA ANDREA DRIZA LILJANA KIÇO DRIZA | 2 | 1+1 |
| 18 | REDI PAVLI JORGONI | 4 | 3+1 |
| 19 | THIMI NDINI NGJELIU | 6 | 3+1 |
| 20 | ALBERT VLASH CURRI ANTONETA ENRIK CURRI | 1 | 1+1 |
| 21 | ARTOR GJERGO BRUNILDA GJERGO | 4 | 2+1 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 22 | REMZIJE SHABAN MARA<br>ENVER HAKI MARA<br>ZAMIRA HAKI MARA<br>ILIR HAKI MARA<br>HAKI MARA<br>BARDHYL HAKI MARA | 1+4+4 | 3+1 |
| 23 | FESTIM SHAULLI,<br>GENTIANA GUCE | 6 | 3+1 |
| 24 | ASTRIT SHEHU,<br>MAJLINDA SHEHU | 2 | 1+1 |
| 25 | ARDIANA SELIMAJ,<br>AFERDITA HYSKA,<br>ETLEVA HYSKA,<br>XHEVRIJE HYSKA | 12(4+6+2) | 3+1 |
| 26 | FATMIRE KAZAZI,<br>KEJVIN KAZAZI | 2 | 1+1 |
| 27 | BEDRIJE MEHMUD RULI,<br>EDUARD ZYHDI RULI | 3 | 2+1 |
| 28 | ADEM SHEFQET DISHA,<br>ENVERIE BEJAZ YZEIRI | 6 | 3+1 |
| 29 | ELVIRA BOLLOBANI,<br>ALBERT BOLLOBANI | 3+1 | 2+1 |
| 30 | GANI MUHARREM<br>SADIKU SERVETE SELIM<br>SADIKU | 4 | 2+1 |
| 31 | DRITA JEMIN VEZI,<br>ZAMIR FAIK VEZI,<br>SHPENDI FAIK VEZI | 1+3 | 2+1 |
| 32 | ANDREA KOSTANDIN<br>STASI, ATHINA SPIRO<br>STASI, ARIAN ANDREA<br>STASI, MIRTON ANDREA<br>STASI | 9(5+4) | 3+1 |
| 33 | SHEFQET HASAN SHANI,<br>KIMETE ESAT SHANI | 2 | 1+1 |
| 34 | FRANO IVO KALEBOTA,<br>ELIBETI FADIL<br>KALEBOTA | 2 | 1+1 |
| 35 | THEOFILLO POLIKRON<br>GJOKA, ELENI LLAMBI<br>GJOKA, SOKOL<br>THEOFILLO GJOKA | 4+2 | 3+1 |
| 36 | THOMA BABI, ELIDA<br>BABI | 5 | 3+1 |
| 37 | MIHAL SOKRAT KIKA,<br>TATJANA SOTIR KIKA | 2 | 1+1 |
| 38 | YLBER VESEL SHABANI | 3 | 2+1 |

SEKRETARIA ... KËSHILLI I QARKUT DURRËS

| | | | |
|---|---|---|---|
| 39 | THANAS LITI, EVA SPIRO LITI | 3 | 2+1 |
| 40 | BARDHYL RAMAZAN META, ARMAND RAMAZAN META | 6(4+2) | 3+1 |
| 41 | BESNIK ARUÇ LIKMETA, FULLANXA RAMIZ LIKMETA | 5 | 3+1 |
| 42 | ARDIAN NAMIR KORRA, YLLI HYSEN HALLULLI, ENKELEJDA ESTREF HALLULLI | 4+5 | 3+1 |
| 43 | ADMIRIM SELIM BALLA, JULIA TAQO BALLA | 5 | 3+1 |
| 44 | ARMAND NJAZI KAMBO, HANEME BARIQ KAMBO, ARDIAN NYAZI KAMBO | 4+1+4 | 3+1 |
| 45 | TATIANA SHAHIN NAKO, ALBA NAKO, SUELA NAKO | 2+2 | 2+1 |
| 46 | PELLUMB ALLIU | 5 | 3+1 |
| 47 | DHIMITER VANGJEL QOSJA | 4 | 2+1 |
| 48 | HAKI STAFA, ALBINA STAFA | 4 | 2+1 |
| 49 | HASAN KACUQI | 4 | 2+1 |
| 50 | ARTUR LLESHI, TONIN LLESHI, NINA LLESHI | 4+4 | 3+1 |
| 51 | ARLIND BELUL VEIZAJ | 1 | 1+1 |
| 52 | ENVER LLANI PRANVERA LLANI | 2 | 1+1 |
| 53 | EDUART KAÇELI | 2 | 1+1 |
| 54 | KUJTIM LLUCA NEXHMIJE LLUCA | 5 | 3+1 |
| 55 | HALIL ALI RRUSHI | 3 | 2+1 |
| 56 | LAZAR DHIMA, ASPASIJA DHIMA, KELER DHIMA | 7 | 3+1 |
| 57 | FERIK DEMA, KLODJANA DEMA | 4 | 2+1 |
| 58 | PETRO DEMIR BEQIRI | 5 | 3+1 |
| 59 | XHEMAL GJYLI | 4 | 2+1 |
| 60 | SHABAN BEQIR HASA, LENIZA TASIM HASA | 4 | 2+1 |
| 61 | ENGJELLUSHE XHAFER DACAJ | 1 | 1+1 |
| 62 | MIRIANA SHKODRA | 3 | 2+1 |

SEKRETARIA BASHKIA DURRËS

| | | | |
|---|---|---|---|
| 63 | YLLI SEMA MARJANA SEMA | 4 | 2+1 |
| 64 | SHQIPE BELI(MUHO), FATMIR BELI, ROBERT BELI | 10 | 3+1 |
| 65 | ALI DOÇI, DHURATA DOÇI | 3 | 2+1 |
| 66 | EDMOND IRAKLI SHTAMBARI, VANGJELIA MILTIADH SHTAMBARI | 3 | 2+1 |
| 67 | ISMAIL KURTI LUIZA KURTI | 5 | 3+1 |
| 68 | BESNIK IDRIZ KACI | 4 | 2+1 |
| 69 | SANIJE PUPA+ERION PUPA | 2(1+1) | 1+1 |
| 70 | NAXHIJE ALI TOLA ILIR FASLLI TOLA | 5 | 3+1 |
| 71 | KADRI BEQIR SEJKO HAJRIJE FERHAT SEJKO NAZMI KADRI SEJKO LULJETA AZEM SEJKO | 8 (2+6) | 3+1 |
| 72 | DIANA XHEVAHIR ZAGANJARI | 3 | 1+1 |
| 73 | LORAND JORGJI PASTERMA VALENTINA JANI PASTERMA | 3 | 2+1 |
| 74 | ALFRED FILIARI + ANGJELINA FILIARI | 4 | 2+1 |
| 75 | SKENDER DALIP HASA | 6 | 3+1 |
| 76 | ALEKSANDRA ANDON PAPINGU, ALKET BUJAR MEZINI | 5 | 3+1 |
| 77 | DRITAN XHELILAJ | 5 | 2+1 |
| 78 | MARA KONESHA ALBAN KONESHA | 5 | 3+1 |
| 79 | KLANTH MIHAL TRANDAFILI | 4 | 2+1 |
| 80 | LIRIM ZALI IBRAHIMI ENTELA REXHEP IBRAHIMI | 4 | 2+1 |
| 81 | EMRUSH AHMEDAN MAZARI, SABRIJE AHMEDAN MAZARI | 2 | 1+1 |
| 82 | ANILA ISA TAHIRI BUKURI LUTO DALIPI | 5 (4+1) | 3+1 |
| 83 | VASILIKA RROSHI | 1 | 1+1 |
| 84 | MICURIN NASTO | 4 | 2+1 |

SEKRETARIA E BASHKIA DURRËS

| | | | |
|---|---|---|---|
| 85 | BENAN SHEHU ZHANETA SHEHU ANDI SHEHU | 6 | 3+1 |
| 86 | SOTIRAQ ANASTAS DHIMITRI, ELSA STAVRI DHIMITRI | 2 | 1+1 |
| 87 | SELAHUDIN AHMETI NATASHA AHMETI | 2 | 1+1 |
| 88 | EDMOND TROSHKU | 4 | 2+1 |
| 89 | SHEFIT MEÇAJ | 3 | 2+1 |
| 90 | YMER DALIP BALLA, SHEJE BAJRAM BALLA, MERITA YMER BALLA, ARDJAN YMER BALLA, GENCI YMER BALLA | 12 (1+2+5+4) | 3+1 |
| 91 | BASHKIM BARJAM KUME | 4 | 2+1 |
| 92 | RUZHDI PLAKU | 4 | 2+1 |
| 93 | ISUF ZENUNI | 4 | 2+1 |
| 94 | PETRIT STAFA | 3 | 2+1 |
| 95 | KUJTIM TOSKA | 3 | 2+1 |
| 96 | CAUSH GISHTO | 4 | 2+1 |
| 97 | ARJAN NDOJA + ALBAN NDOJA +VERONIKA NDOJA | 3 | 2+1 |
| 98 | VASIL FLAMUR HAXHI | 4 | 2+1 |

SEKRETARIA BASHKIA DURRËS

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT DURRËS**

Nr.246/4 prot. Durrës, më 07.04.2021

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 32 datë 26.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, L.17, rruga "Lura", pallatet Nr. 1 dhe 3, dhe rruga "Ahmet Dakli", pallatet Nr. 15 dhe 23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**